

platforma

CiviKos

**Raport i punës së
Platformës CiviKos
për vitin 2012-2013**

Bashkëpunimi formal me Qeverinë e Kosovës

Përmes vendimit të Zyrës së Kryeministrit, në shtator 2011 me vendimin e Sekretarit të Përgjithshëm të Zyrës së Kryeministrit, Zyra për Qeverisje të Mirë në kuadër të Zyrës së Kryeministrit (ZKM/ZQM) është mandatuar si përgjegjëse për hartimin e Strategjisë për bashkëpunim me shoqërinë civile. ZKM/ZQM në bashkëpunim me Zyrën Ligjore dhe Zyrën për Planifikim Strategjik në kuadër të Zyrës së Kryeministrit kanë themeluar grupin nismëtar për hartim të strategjisë për bashkëpunim me shoqërinë civile. Në këtë grup janë përfshirë edhe organizatat e shoqërisë civile të përfaqësuara nga Platforma CiviKos, Fondacioni Kosovar për Shoqëri civile (KCSF) dhe Instituti Demokratik i Kosovës (KDI).

Grupi nismëtar ka bërë identifikimin e çështjeve kyçe që duhet adresuar përmes kësaj strategjie dhe ka përgatitur metodologjinë e punës për një proces gjithëpërfshirës të hartimit të strategjisë për bashkëpunim, duke marrë për bazë draft dokumentet e konsultimeve të mëparshme.

Çështjet kryesore të cilat kanë dalë të jenë të domosdoshme dhe të adresohen përmes Strategjisë për bashkëpunim me shoqërinë civile janë:

- Sigurimi i pjesëmarrjes së shoqërisë civile në hartimin dhe zbatimin e politikave dhe legjislacionit;
- Kontraktimi i shërbimeve publike tek organizatat e shoqërisë civile;
- Ndërtimi i sistemit dhe përcaktimi i kriterëve për përkrahje financiare për OSHC

Me 07 Shkurt 2013 në bashkëpunim me Zyrën e Kryeministrit/Zyra për Qeverisje të Mirë është organizuar një takim pune për zhvillimin e draft Planit të veprimit për zbatimin e Strategjisë për bashkëpunim Qeveri – Shoqëri civile lidhur me vullnetarizmin. Qëllimi i takimit ishte zhvillimi i komponentës së vullnetarizmit e cila më vonë u bë pjesë e Strategjisë dhe Planit të veprimit për bashkëpunim qeveri –shoqëri civile. Gjatë këtij takimi u finalizua draft plani i veprimit për bashkëpunim Qeveri –shoqëri civile të plotësuar nga grupi me komponentët e vullnetarizmit.

Hartimi i Strategjisë Qeveritare për bashkëpunim me shoqërinë civile

Konsultimet e përbashkëta (shoqëri civile dhe institucione) për hartim të strategjisë dhe planit të veprimit gjatë vitit 2012

27-30 Prill, Durrës Shqipëri. Pas finalizimit të draftit të parë të strategjisë në fjalë, Platforma CiviKos së bashku me grupin nismëtar për hartim të strategjisë organizuan punëtorinë tre ditore me qëllim të finalizimit të strategjisë si dhe përfshirjes të sa më shumë përfaqësuesve të organizatave të shoqërisë civile si dhe zyrtarëve të qeverisë në këtë proces, respektivisht institucionet relevante si: Ministria e Administratës Publike, Ministria e Integriteteve Evropiane, Ministria e Pushtetit Lokal, Ministria e Financave, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale si dhe përfaqësues të administratës tatimore si dhe tri zyrat e kryeministrit, ZQM, Zyra Ligjore, Zyra për Planifikim Strategjik.

19 Prill, Prishtinë. Takim informues dhe konsultues rreth strategjisë me përfaqësues të institucioneve dhe përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile, ku morrën pjesë një numër i madh i pjesëmarrësve nga të dy sektorët.

18 Qershor, Prishtinë. Konsultim publik mbi draftin e Kornizës logjike të strategjisë për bashkëpunim me shoqërinë civile, me përfaqësues të institucioneve dhe shoqërisë civile, anëtarë të Platformës CiviKos.

4 - 6 Nëntor, Durrës. Pas përfundimit të draftit final të Kornizës Logjike të Strategjisë, u organizuan punëtori të ndryshme me qëllim të hartimit të planit të veprimit të Strategjisë për bashkëpunim në mes të Qeverisë së Kosovës dhe organizatave të shoqërisë civile, fillimisht grupi nismëtar (me 2-3 Nëntor) që e përgatiti një draft të parë, e më pas kësaj punëtorie iu bashkangjitën përfaqësues të shoqërisë civile dhe zyrtarë të ndryshëm nga Institucionet Qeveritare të Republikës së Kosovës. Gjatë punëtorisë dy ditore, pas diskutimeve të shumta u finalizua Plani i Veprimit të Strategjisë, përkatësisht u përcaktuan përgjegjësit e veprimeve

(aktiviteteve) të dala nga strategjia, si dhe kostoja e përafërt për realizimin e tyre.

Në fillim të vitit 2013 kanë vazhduar takimet intensive mes Platformës CiviKos dhe ZK/ZQM (Zyra e Kryeministrit/ Zyra për Qeverisje të Mirë), ku edhe u finalizua Strategjia.

CiviKos në përkrahje të hartimit të Strategjisë ka kontraktuar ekspertët/organizatat vendore që të bëjnë analiza të cilat kanë kontribuar në hartim të strategjisë dhe do të kontribuojnë në zbatim. Këto analiza janë: Analizë e Kornizës Ligjore për Çështjet Fiskale të OJQ-ve në Kosovë, Analizë – Shoqëria Civile dhe Shërbimet Publike dhe Analizë – Vullnetarizëm për Zhvillim, Zhvillimi i Kornizës Ligjore për Njohjen dhe Promovimin e Vullnetarizmit në Kosovë. Të gjitha këto analiza janë të publikuara në web-faqen e Platformës CiviKos.

Konsultimet publike me organizatat anëtare të Platformës CiviKos gjatë vitit 2012

Me qëllim të përfshirjes së anëtarëve të vet, gjatë vitit 2012, në kuadër të angazhimeve për hartimin e një strategjie sa më gjithëpërfshirëse për bashkëpunim në mes të Qeverisë së Kosovës dhe organizatave të shoqërisë civile, grupi nismëtar për hartim të strategjisë ka konsideruar si të domosdoshëm organizimin e takimeve konsultative me anëtarët e vet lidhur me draftin e parë të strategjisë për bashkëpunim. Konsultimet u organizuan në disa qendra të Kosovës si:

19 Qershor, Pejë. Platforma CiviKos ka organizuar konsultime publike me organizatat anëtare të Rajonit të Pejës, që poashtu kanë përfshirë edhe komunat: Klinë, Deqan, Istog dhe Gjakovë ku kanë marrë pjesë një numër i konsiderueshëm i organizatave aktive dhe kanë dhënë mbështetjen respektivisht sygjerime për draft strategjinë.

22 Qershor, Mitrovicë. Në këto konsultime janë përfshirë edhe anëtarë nga komunat e rajonit të Mitrovicës si: Vushtrria, Skenderaj dhe Zveçani. Përveç pyetjeve dhe diskutimeve rreth strategjisë pjesmarrësit kishin edhe pyetje shtesë për përfaqësuesit e Institucioneve, respektivisht ZQM-së.

19 Shtator, Ferizaj. Ky konsultim poashtu ka përfshirë edhe përfaqësuesit e organizatave nga komunat e Kamenicës, Vitisë dhe Gjilanit. Edhe pse numri nuk ishte aq i madh sikur në komunat tjera, pjesmarrësit kanë dhënë kontribute të çmueshme rreth strategjisë, respektivisht zbatimit të saj.

12-13 Prill, Durrës. Ministria e Administratës Publike, respektivisht DRNOJQ në bashkëpunim me KCSF-në dhe CiviKos kanë organizuar punëtorinë për Udhëzuesin Administrativ për Ligjin për OJQ-të, me përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile dhe institucioneve relevante.

Shkëmbimi i përvojave me vendet e rajonit dhe shtetet e Evropës si dhe bashkëpunimi me organizata ndërkombëtare gjatë 2012-2013

Duke u nisur nga fillimi i procesit të strukturimit të marrëdhënieve të bashkëpunimit në mes të sektorit të shoqërisë civile dhe Qeverisë së Kosovës, në mungesë të praktikave të ngjashme në Kosovë, baza mbi të cilën kanë filluar diskutimet për ndërtimin e këtij bashkëpunimi janë praktikat e mira të bashkëpunimit nga vendet e rajonit dhe Evropës.

Në këtë drejtim, duke u nisur nga fakti se modeli kroat i bashkëpunimit në mes të sektorit të shoqërisë civile dhe Qeverisë konsiderohet ndër më të suksesshmit në rajon, dhe me qëllim të shkëmbimit të praktikave të mira nga Republika e Kroacisë, Platforma CiviKos në shkurt të 2012 ka ftuar në Kosovë znj. Vesna Lendic Kasalo, e cila ishte koordinatore për implementim të strategjisë së bashkëpunimit në kuadër të Zyrës për Bashkëpunim me OJQ pranë Qeverisë së Republikës së Kroacisë.

Në kuadër të kësaj vizite, janë organizuar punëtoritë:

- Më 23 Shkurt 2012, në Prishtinë është organizuar takim ku kanë qenë të ftuara të gjitha organizatat anëtare të Platformës CiviKos – takim në të cilin është diskutuar mbi qasjen e Qeverisë së Kroacisë në strukturimin e bashkëpunimit me shoqërinë civile, rëndësinë e strukturimit të bashkëpunimit në mes të dy sektorëve, rezultatet konkrete si dhe sfidat kryesore deri më tani.
- Më 24 Shkurt 2012, në Prishtinë është organizuar një punëtori një ditore me grupin nismëtar për hartim të strategjisë për bashkëpunim në mes të Qeverisë së Kosovës dhe organizatave të shoqërisë civile, ku është bërë prezantimi i praktikave të mira të Republikës së Kroacisë në këtë drejtim, përparësitë dhe sfidat më të cilat janë ballafaquar ata. Punëtorja është përmbyllur me diskutim mbi draftin e parë të strategjisë për bashkëpunim të Republikës së Kosovës;

23-26 Prill, 2012. Pjesëmarrje në vizitë studimore në Poloni e udhëheqëses së CiviKos-it, në kuadër të programit P2P të Komisionit Evropian, , në të cilën vizitë kanë qenë të ftuar nga dy përfaqësues të Ballkanit dhe Turqisë, rajon ku edhe operon projekti i KE-së, TACSO. Në kuadër të vizitës, janë organizuar takime me organizata të ndryshme të shoqërisë civile, rrjete sektoriale dhe ndërsektoriale, fondacione të ndryshme si dhe shtëpitë e OSHC-ve, që kanë qenë të përkrahura nga qeveria e Polonisë, falë një dialogu dhe bashkëpunimi të strukturuar në mes sektorit të shoqërisë civile dhe institucioneve qeveritare atje.



14-18 Maj 2012. Vizitë studimore në Poloni. Përveç strukturimit të bashkëpunimit në mes të Qeverisë së Kosovës dhe organizatave të shoqërisë civile, Platforma CiviKos është e interesuar në zgjerimin e këtij bashkëpunimi, përkatësisht strukturimin e bashkëpunimit edhe me Kuvendin e Kosovës. Në këtë drejtim, në prill 2012, Platforma CiviKos në bashkëpunim me Fondacioni për Mbështetje të Demokracisë Lokale (FSLD) nga Polonia dhe të mbështetur nga TACSO Kosovë ka organizuar vizitë studimore në Poloni. Qëllimi kryesor i kësaj vizite ishte që t'i kontribuojë dokumentit të strategjisë së bashkëpunimit mes qeverisë dhe OSHC-ve, që në atë kohë ishte në përgatitje e sipër. Në kuadër të programit u realizuan takime për t'u njoftuar me mënyrën e bashkëpunimit në mes të qeverisë polake dhe OSHC-ve në të tre nivelet: qendror, rajonal dhe lokal. Gjatë vizitës u realizuan takime në Zyrën (Kancelarinë) e Presidentit të Republikës së Polonisë, Parlamentin e Polonisë, Sejm-in e Republikës së Polonisë (Dhoma e Ulët e Parlamentit polak), Ministrinë e Punës dhe Politikës Sociale, Ministrinë e Kulturës dhe Trashëgimisë Polake, administratën e komunës së Legionovo dhe punëtorja me përfaqësuesit e OSHC-ve polake, përfshirë edhe rrjetet e organizatave të shoqërisë civile. Diskutimi u përqendrua në çështjet që kanë të bëjnë me ngritjen e kapaciteteve dhe hartimin e politikave dhe gjendjen aktuale të bashkëpunimit në mes qeverisë dhe OSHC-ve në Poloni.

Delegacioni që mori pjesë në vizitën studimore treditore ishte i përbërë nga grupi nismëtarë për hartim të strategjisë si dhe zyrtari i lartë ligjor për partneritet evropian dhe koordinim të donatorëve në kuadër të Parlamentit të Kosovës.



14-16 Qershor, 2013. Vizitë studimore në Kroaci. Në kuadër të shkëmbimit të përvojave u organizua edhe një vizitë studimore individuale në Kroaci. Vizita ishte organizuar me qëllim që të ngritet kapaciteti i stafit të Platformës Civike përmes rrjetëzimit me OJQ-të nga rajoni. Gjatë tre ditëve të vizitës zyrtare në Kroaci, Koordinatorja e Sekretariatit morri pjesë në aktivitete të ndryshme si: pjesëmarrja në panel diskutimin e organizuar nga Zyra për bashkëpunim me OJQ-të, Qeveria e Republikës së Kroacisë me temën “Organizatet e shoqërisë Civile dhe Institucionet e Bashkësisë së Evropës: Çfarë dialogu mundemi të presim?”.

Po ashtu janë organizuar edhe disa takime me OJQ-të nga Kroaci në kuadër të Dyerve të Hapura të OJQ-ve 2013, si takimet me Qendrën e Vullnetarëve në Zagreb, OJQ “ODRAZ” dhe OJQ Forum for Freedom in Education. Të gjitha këto OJQ ishin të angazhuara si partner implementues të disa masave të Strategjisë Qeveritare Kroate (2006 – 2011) dhe ata kontribuan me këshilla dhe rekomandime konkrete rreth metodologjisë dhe mjeteve për implementimin e suksesshëm të Strategjisë. Po ashtu u organizua edhe një takim me Zyrën për bashkëpunim me OJQ-të, Qeveria e Republikës së Kroacisë, me zëvendës-drejtoreshën Vesna Lendic Kasalo dhe me Zyrtareshen e lartë Sandra Kasalo. Ato së pari i prezantuan aktivitetet e Zyrës së tyre, e me pastaj u diskutua më detajisht rreth Strategjisë Qeveritare për krijim të një ambienti të favorshëm për Shoqërinë Civile në Kroaci (2012 – 2016).



31 Tetor 2013, Londër. Në kuadër të projektit të OGP-së, kordinatorja e Platformës ka marrë pjesë në takimin e organizatave të shoqërisë civile, me qëllim që të shkëmbejë sa më shumë informata si dhe të mësojë më shumë rreth bashkëpunimit në mes institucioneve në hartim të planeve si dhe procesit të monitorimit të procesit të OGP-së nga organizatat e shoqërisë civile.

Ndër të tjera, Platforma CiviKos është e angazhuar në krijimin e një ambienti të favorshëm për veprim të organizatave të shoqërisë civile. Në këtë drejtim, Platforma CiviKos është përfshirë në të gjitha nismat që kanë konsistuar në krijimin një ambienti më të favorshëm për ushtrimin e veprimtarisë së OSHC-ve.

Në nismën e OSCE-së për ndërtimin e mekanizmave formal të bashkëpunimit në mes të Kuvendit dhe shoqërisë civile, Platforma CiviKos ka qenë e përfshirë qysh nga fillimi. Në këtë mënyrë, Platforma CiviKos ka dhënë kontribut esencial në konceptimin e bazës së të dhënave të OSHC-ve të ndërtuar nga OSCE.

Platforma CiviKos ka pasur takime të rregullta me akterë të tjerë, përfshirë edhe donatorët, ku ndër të tjera është diskutuar roli që mund ta ketë Platforma CiviKos në të ardhmen në Platformën e Donatorëve Ndërkombëtar në Kosovë. Pjesëmarrja në takime, konferenca, punëtori rajonale ka qenë pothuajse pjesë e përditshmërisë së punës të Platformës CiviKos.

Aprovimi i Strategjisë

Pas konsultimeve të shumta Qeveria e Republikës së Kosovës në mbledhjen e mbajtur me datë 05 korrik 2013 ka aprovuar Strategjinë Qeveritare për bashkëpunim me shoqërinë civile si dhe dhe Planin e Veprimit 2013-2017.

Strategjia paraqet bazat e bashkëpunimit të Qeverisë me shoqërinë civile në Kosovë, duke e obliguar Qeverinë e Republikës së Kosovës që të angazhohet fuqishëm në krijimin e kushteve të favorshme për zhvillimin e sektorit të shoqërisë civile. Zyra e Kryeministrit/ Zyra për Qeverisje të Mirë, e mandatuara nga Kryeministri për zbatimin e strategjisë, me ndihmën e CiviKos-it do të jetë përgjegjëse për koordinimin e gjithë procesit të zbatimit të Strategjisë dhe Planit të Veprimit, ndërsa për të siguruar një qasje të pavarur në mbikëqyrjen dhe vlerësimin e suksesit të zbatimit të kësaj Strategjie do të themelohet një Këshill i përbashkët me pjesëmarrjen e të dyja palëve.

Po ashtu njoftimi për aprovimin e Strategjisë është përcjellë tek të gjithë organizatat anëtarë, si dhe është bërë publike edhe në ëeb faqen e Platformës CiviKos.

Pas aprovimit të strategjisë janë mbajtur takime të rregullta pune me Zyrën për Qeverisje të Mirë për hapat e më tutjeshëm, si dhe për themelimin e mekanizmave zbatues të strategjisë si Këshilli për Zbatim të Strategjisë dhe grupet punuese për secilën komponentë të strategjisë, të cilat pritet të themelohen menjëherë pas vendimit të Qeverisë për Këshill, në pjesën e parë të vitit 2014.

Informimi i anëtarëve i procesit të hartimit të politikave dhe legjislacionit dhe bashkëpunimi me Institucione qeveritare

Falë bashkëpunimit të ngushtë në mes të Zyrës së Kryeministrit/Zyrës Ligjore dhe Platformës CiviKos, që nga Janari 2012, me kërkesën e Drejtorit të Zyrës Ligjore në Zyrën e Kryeministrit, të gjitha ministritë kanë marrë për obligim gjatë procesit të hartimit/plotësimit/ndryshimit të politikave ta konsultojnë Platformën CiviKos, e që kjo e fundit më pas ta ndajë informatën me organizatat anëtare, dhe në këtë mënyrë të ndërtohet kanali i bashkëpunimit në procesin e hartimit të politikave publike. Edhe pse një numër i madh draft ligjesh dërgohet për konsultim publik tek anëtarët, ende ka një numër i ligjeve që nuk dërgohen tek anëtarët. Platforma CiviKos në mënyrë konstante e adreson këtë çështje si dhe përfshirjen apo mospërfshirjen e kontributeve në këto draft ligje që vijnë nga përfaqësues të shoqërisë civile. Aktualisht Platforma CiviKos bën vetëm shpërndarjen e dokumenteve për konsultim tek organizatat anëtare dhe jo mbledhjen e kontributeve

të tyre. Në mungesë të një sistemi standard të ndërtuar për këtë çështje, vlerësimi i kontributeve të dërguara nga organizatat anëtare të Platformës CiviKos në ministritë përkatëse të Republikës së Kosovës është tejet i vështirë.

Gjatë vitit 2012, Platforma CiviKos ka shpërndarë organizatave anëtarë 66 Projektligje për konsultim paraprak, e gjatë 2013-ës janë përcjellë tek anëtarët 45 draft ligje dhe udhëzime administrative.

Pas ngritjes së çështjes së përfshirjes apo mospërfshirjes së kontributeve në draft ligje nga organizatat, e njëkohësisht për të parë se sa janë aktive organizatat anëtare në këtë proces të konsultimit Platforma CiviKos ka bërë një hulumtim, ka përpiluar dhe dërguar një pyetësor tek anëtarët e CiviKos-it duke shfrytëzuar platformën online SurveyMonkey. Në këtë pyetësor janë përgjigjur vetëm 28 organizata, anëtare në Platformën CiviKos, por nga përgjigjet shihet se angazhimi i organizatave me kontribute është më i madh sesa perceptcionet që vijnë nga disa institucione. CiviKos do të vazhdojë me hulumtime të tilla edhe në të ardhmen në mënyrë që të ndihmojë dhe përmirësojë procesin e konsultimit të legjislationit me OSHC-të. Raporti me rekomandime konkrete është bërë publik në faqen e CiviKos.

Si rrjedhojë e fillimit të bashkëpunimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Platformës CiviKos, përveç ftesave për pjesëmarrje në hartim të politikave publike, Platforma CiviKos është bërë adresë e Qeverisë së Kosovës për shumë çështje që kanë të bëjnë me shoqërinë civile. Gjatë verës së 2012ës (Korrik-Shtator), Platforma CiviKos ka asistuar Ministrinë e Shëndetësisë në hartimin e procesit të përzgjedhjes së përfaqësuesve të shoqërisë civile në Mekanizmin Koordinues të Kosovës, në kuadër të projektit të Fondit Global për luftimin dhe parandalimin e Tuberkulozës dhe HIV/AIDS, duke siguruar pjesëmarrjen e përfaqësuesve të organizatave në këtë program, pas një procesi konsultativ dhe gjithëpërfshirës.

Takime të rregullta informative ka pasë edhe me Institucione të tjera, ministri të ndryshme, Kuvendin dhe presidencën e Kosovës.

Konsolidimi dhe fuqizimi i Sekretariatit të Platformës CiviKos

Platforma CiviKos vetëm gjatë vitit 2013 ka arritë të kompletohet me personel dhe në këtë mënyrë edhe puna bëhet më e lehtë karshi kërkesave që kemi nga anëtarët të Platformës, bazuar në faktin se numri i anëtarëve të Platformës CiviKos tashmë është trefishuar si dhe kërkesat janë më të shumta. Në kuadër të fuqizimit të sekretariatit, të ngritjes së kapaciteteve të stafit dhe fillimin e implementimit të projektit të Komisionit Evropian, anëtarët e Sekretariatit të Platformës CiviKos morën pjesë në një sërë trajnimesh të vazhdueshme që kontribuan në ngritje të kapaciteteve të tyre, si në trajnim në fushë të financave me fokus të veçantë në Menaxhim të Fondeve të BE-së, trajnim për shfrytëzim të medieve etj.

Në kuadër të projektit të KE-së “Duke punuar së bashku - Drejt një marrëdhënie pune produktive në mes të Shoqërisë Civile dhe Autoriteteve në Kosovë” është paraparë rritja e numrit të punonjësve në Platformën CiviKos, andaj me procedurat e rregullta të punësimit, së pari me shpallje publike e pastaj me intervistim, Sekretariati i Platformës CiviKos ka punësuar disa persona për këto pozita dhe ka plotësuar numrin e nevojshëm për Sekretariat: Koordinatorja e Sekretariatit e cila po ashtu ushtron detyrën e menaxheres së projektit të KE-se, Zyrtarja për financa (pozitë ekzistuese e mëhershme), Zyrtare për informim (pozitë ekzistuese e mëhershme), Zyrtar për monitorim, vlerësim dhe raportim dhe tre praktikantë. Sekretariati i Platformës CiviKos është i përbërë nga: Valdete Idrizi – Drejtore ekzekutive, Mimoza Murati – Koordinatore e Sekretariatit, Dardan Kryeziu – Zyrtar për monitorim, vlerësim dhe raportim, Ardiana Osmani – Zyrtare për komunikim dhe informim dhe Zana Peci – Menaxhere Financiare. Programi i praktikantëve në CiviKos ka filluar që nga Tetori 2013 dhe do të vazhdojë edhe në të ardhmen. Që nga fillimi deri me sot kanë qenë të angazhuar Arbër Nimani, Shqipe Kryeziu, Besana Shehaj Latifi.

Po ashtu me përkrahje financiare nga projekti i KE-së zyra e Sekretariatit të Platformës CiviKos që gjindet në ndërtesën e KCSF-së është pajisur me pajisjet e reja për punë si tryeza pune, kompjuter, printer, projektor etj. Salla për takime që nga 01.09.2013 iu është dhënë në shërbim falas anëtarëve për shërbim, ku disa nga organizatat tashmë veq e kanë shfrytëzuar.

Bordi i Platformës CiviKos ka luajtur një rol shumë të rëndësishëm në zhvillimin dhe zgjerimin e Platformës

CiviKos. Takimet e rregullta të Bordit janë mbajtur rregullisht ku gjithnjë ka pasur diskutim konstruktiv rreth zhvillimeve të Platformës CiviKos si dhe sygjerime dhe ide se si të ecet përpara. Anëtarët e Bordit, të zgjedhur në nëntor 2011 janë: Taulant Hoxha (KCSF) kryesues, Driton Bajraktari (Down Syndrome Kosova), Ismet Kryeziu (KDI), Luljeta Vuniqi (QKSGJ), Petrit Tahiri (KEC), Valbona Salihu (NORMA), Veton Mujaj (Syri i Vizionit) dhe Sihana Xhaferi (KFOS) anëtare e bordit pa të drejtë vote.

Numri i anëtarëve aktual të Platformës CiviKos, 130 por edhe interesimi nga organizatat tjera për t'u anëtarësuar është në rritje.

Fuqizimi i vazhdueshëm i Platformës CiviKos

Si nevojë e funksionimit më të mirë të Platformës CiviKos, janë përpiluar disa draft dokumente të cilat rregullojnë mënyrën e funksionimit të Platformës CiviKos. Me përkrahje financiare nga zyra e projektit të Asistencës Teknike për Organizatat e Shoqërisë Civile (**TACSO**) në Kosovë, është kontraktuar **CNVOS** (Centre for information service, co-operation and development of NGOs) nga Sllovenia, dhe ekspertë lokal për ti përpiluar draftet e para të këtyre dokumenteve:

- **Kodi i Mirësjelljes** - Kodi i mirësjelljes, është përpiluar me angazhimin e një eksperti lokal (Hajrullah Çeku) nga Platforma CiviKos. Pyetësori për kodin e mirësjelljes ju është dërguar të gjitha organizatave anëtare në maj të vitit 2013, ku sugjerimet e anëtareve kanë shërbyer si bazë për përpilimin e këtij dokumenti.

Në 10 tetor 2013 është mbajtur takimi i parë konsultativ në Prishtinë për Kodin e Mirësjelljes ku dhe kompletohet drafti i parë i këtij dokumenti.



Takimi i parë konsultativ në Prishtinë për Kodin e Mirësjelljes

- **Rregullat e Procedurës për zbatimin e aktiviteteve të Platformës CiviKos** - Më 17 Qershor, Platforma CiviKos organizoi një punëtori me pjesëmarrje të rreth 25 organizatave anëtare, ku CNVOS-i prezantoi dokumentin “Rregullat e procedurës për zbatimin e aktiviteteve të Platformës CiviKos” të përpiluar për Platformën CiviKos me përkrahjen financiare nga Zyra e projektit të Asistencës Teknike për Organizatat e Shoqërisë Civile (TACSO) në Kosovë.

Në mënyrë që të sigurohen dokumente sa me funksionale dhe gjithëpërfshirëse CiviKos me përkrahje nga TACSO gjatë periudhës tetor-nëntor 2013 ka organizuar takime konsultative me përfaqësues të OSHC-ve në 5 regjione të Kosovës. Takimet njëditore janë realizuar në Mitrovicë, Prizren, Gjakovë, Gjiilan dhe Prishtinë, ku i kanë përfshirë edhe organizatat nga komunat tjera. Procesi i konsultimeve është bërë edhe në formë elektronike, duke i përfshirë të gjitha organizatat anëtare dhe ato jo anëtare të CiviKos. Gjatë këtyre takimeve konsultative është diskutuar edhe për Statutin e Platformës CiviKos, Qendrave Regjionale që CiviKos pritet t'i hap në 4 Regjione të Kosovës, si dhe për Strategjinë qeveritare për bashkëpunim me Shoqërinë Civile dhe nevojave të tjera të organizatave të shoqërisë civile.

Këtyre takimeve iu janë përgjigjur pozitivisht përfaqësuesit e OSHC-ve anëtare dhe jo anëtare të CiviKos ku

janë pranuar komente dhe sygjerrime të ndryshme për të gjitha dokumentet. Me angazhimin e një eksperti lokal dhe në konsultim me bordin këto sugjerime janë inkorporuar në dokumentet përkatëse. Pas konsultimeve nëpër të gjitha qendrat e Kosovës, pas përfshirjes së të gjitha komenteve nga anëtarët, sekretariati dhe anëtarët e Bordit kanë finalizuar dokumentet finale të cilat kanë qarkulluar tek anëtarët për një konsultim përfundimtar me shkrim me të gjitha organizatat anëtare e që ka zgjatur jo më pak se një muaj, deri në 28 Shkurt 2014.



Takimi konsultativ në rajonin e Prishtinës



Takimi konsultativ në rajonin e Prizrenit



Takimi konsultativ në rajonin e Mitrovicës



Takimi konsultativ në rajonin e Gjilanit



Takimi konsultativ në rajonin e Gjakovës

Komunikimi shtesë me Anëtarë

Sekretariati i Platformës CiviKos gjatë vitit 2013 përveq dërgimit të draft ligjeve ka shpërndarë edhe njoftimeve të ndryshme si mundësi trajnimi, financimi, por edhe vazhdimisht ka pasur takime individuale me anëtarë në mënyrë që të iu lehtësojë bashkëpunimin dhe rrjetëzimin dhe aplikimin për grantet e Komisionit Evropian, ku anëtarëve iu nevojiteshin informata shtesë qoftë rreth zhvillimeve sa i përket strategjisë dhe në përgjithësi bashkëpunimit në mes sektorit të shoqërisë civile dhe institucioneve qeveritare e poashtu edhe kërkesave për partneritet me anëtarë/organizata të tjera potenciale.

Planifikimi Strategjik i Platformës CiviKos 2014-2017

Sekretariati i Platformës CiviKos, së bashku me anëtarët e Bordit Drejtues të vet, ka mbajtur punëtorinë dy ditore për “Orientimin Strategjik të Platformës CiviKos për tri vitet e ardhshme”. Kjo punëtori mjaft dinamike e cila u mbajt më 6 dhe 7 Dhjetor 2013 në Istog, është përkrahur nga projekti i asistencës teknike TACSO në Kosovë.

Gjatë vitit 2012-2013 për përmbushjen e objektivave të saj si dhe për mbarëvajtjen e aktiviteteve të Platformës CiviKos ishin këta donatorë dhe përkrahës që kontribuan në forma të ndryshme: KFOS që nga fillimi përkrahu sekretariatit me disa projekte, KCSF që ofroi zyret për shfrytëzim pa pagesë gjatë vitit 2012, zyrja TACSO në Kosovë që ofroi përkrahje financiare për organizimin e disa aktiviteteve, si dhe Komisioni Evropian me përkrahjen e një projekti njëvjeçar.

PLATFORMA CIVIKOS

Bilanci i gjendjes

Për fundin e vitit më 31 Dhjetor 2013

	Shënimi	31-Dhjetor-13 (në EUR)	31-Dhjetor-12 (në EUR)
ASETET			
Asetet jo-qarkulluese			
Prona, impiantet dhe paisjet	3	-	-
Totali i aseteve jo-qarkulluese		-	-
Asetet qarkulluese			
Llogaritë e arkëtueshme		-	-
Të arkëtueshme tjera		423	-
Paraja dhe ekuivalentet e parasë	4	31,792	31,121
Totali i aseteve qarkulluese		32,215	31,121
TOTALI I ASETETEVE		32,215	31,121
DETYRIMET DHE EKUITETI			
Detyrimet rrjedhëse			
Ll. e pagueshme		500	400
Të hyrat e shtyera	5	31,655	30,722
Detyrime Tjera		60	-
Totali i detyrimeve rrjedhëse		32,215	31,121
Detyrimet jo-rrjedhëse			
Totali i detyrimeve jo-rrjedhëse		-	-
Ekuiteti			
Kapitali		-	-
Mbetjet nga vitet e kaluara		-	-
Mbetjet nga viti aktual		-	-
Totali i ekutetit		-	-
TOTALI I DETYRIMEVE DHE EKUITETIT		32,215	31,121

Pasqyrat financiare janë nënshkruar më 24 Mars 2014 nga:


Valdete Idrizi
Drejtoreshë Ekzekutive



Shënimet e bashkëngjitura nga 1 në 12 janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare

PLATFORMA CIVIKOS

Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve

Për fundin e vitit më 31 Dhjetor 2013

		Fundi vitit 31 Dhjetor, 2013 (në EUR)	Fundi vitit 31 Dhjetor, 2012 (në EUR)
	Shënimi		
Të hyrat			
Soros dhe Komisioni Evropian	6	86,376	57,572
Totali i të hyrave totale		86,376	57,572
Shpenzimet			
Shp e administratës	7	26,937	10,085
Shpenzimet e programit	8	24,233	24,887
Pagat dhe benefitet	9	35,206	22,600
Totali i shpenzimeve		86,376	57,572
Pjesa e mbetur		-	-

Shënimet e bashkëngjitura nga 1 në 12 janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiar

PLATFORMA CIVIKOS

Pasqyra e rrjedhës së parasë

Për fundin e vitit më 31 Dhjetor 2013

	Fundi i vitit 31 Dhjetor, 2013 (në EUR)	Fundi i vitit 31 Dhjetor, 2012 (në EUR)
Rrjedha e parasë nga aktivitetet operuese		
(Deficiti)/mbetja për periudhën	-	-
Rregulluar për:		
Zhvlerësimi	-	-
Ndryshimet në të arkëtueshme	-	-
Ndryshimet në të arkëtueshme tjera	(423)	-
Ndryshimet në të pagueshme	100	400
Ndryshimet në të pagueshme tjera	60	
Ndryshimet në të hyra të shtyera	934	(7,972)
Paraja neto nga aktivitetet operuese	670	(7,572)
Rrjedha e parasë nga aktivitetet investuese		
Blerja e pronës dhe e paisjeve	-	-
Paraja neto e përdorur në investime	-	-
Ndryshimet neto në para dhe ekuivalent	670	(7,572)
Paraja dhe ekuivalentet e parasë më 1 Janar	31,121	38,693
Paraja dhe ekuivalentet më 31 Dhjetor	31,792	31,121

Shënimet e bashkëngjitura nga 1 në 12 janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiar

LISTA E ANËTARËVE TË PLATFORMËS CIVIKOS

Prill 2014

	Organizata:	Komuna:	Kontakti:
1.	Academy for Training and Technical Assistance (ATTA)	Prizren	info@atta-ks.org
2.	7 Arte	Mitrovicë	shtatearte@yahoo.com
3.	ACDC	Mitrovicë	office@acdc-kosovo.org
4.	Advocacy, Training and Resource Centre (ATRC)	Prishtinë	info@advocacy-center.org
5.	Balkan Sunflowers in Kosovo	Mitrovicë	office@balkansunflowers.org
6.	Bošnjački Savjet Kosova (BSK)	Prizren	bsk_ks@hotmail.com
7.	Childproof/Cipof	Klinë	info.cipof@gmail.com
8.	Community Building Mitrovica- CBM	Mitrovicë	info@cbmitrovica.org
9.	Community Development Fund (CDF)	Prishtinë	Info@kdcf.org
10.	Council for Peace and Tolerance	Mitrovicë	rexhep_lushta@hotmail.com
11.	CSSP	Prishtinë	bismaili@cssproject.org
12.	D&G Solutions	Mitrovicë	ngodgsolutions@gmail.com office@dgsolutions.org
13.	Dankos	Mitrovicë	nvodankos@gmail.com
14.	Demokracia për Zhvillim (D4D)	Prishtinë	info@d4d-ks.org
15.	Down Syndrome Kosova (DSK)	Prishtinë	info@downsyndromekosova.org
16.	Emancipimi Civil Ma Ndryshe (EC MA NDRYSHE)	Prizren	info@ecmandryshe.org
17.	European Union Integration Resource Center (EUIRC)	Prizren	info@euirc-ks.eu
18.	Fondacioni për Mbrojtjen e Mjedisit (FMM)	Prishtinë	fmm.epf@gmail.com
19.	OJQ Fortesa	Kamenicë	sanije200@hotmail.com
20.	Forumi për Integritet dhe Zhvillim (FIZH)	Prishtinë	fizh.rks@gmail.com
21.	Futura	Mitrovicë	futuram03@hotmail.com
22.	Gratë në Biznes (GnB)	Prishtinë	info@gratenebiznes.com
23.	Iniciativa e Femrës Kosovare (IFK)	Prishtinë	kosovaifk@gmail.com
24.	Iniciativa Kosovare për Stabilitet (IKS)	Prishtinë	info@iksweb.org
25.	Iniciativa për Ide dhe Alternativa	Prishtinë	shemsi_jashari@hotmail.com
26.	Iniciativa për Progres (INPO)	Ferizaj	info@inpo-ks.org
27.	Instituti Ballkanik i Politikave – IPOL	Prishtinë	office@policyinstitute.eu
28.	Instituti për Avancim të Edukimit dhe Arsimimit (IAEA)	Gjilan	fatmirlatifaj60@hotmail.com
29.	Këshilli Rinor Kosovar (KYC)	Prishtinë	kyckosova@gmail.com
30.	KIPRED	Prishtinë	info@kipred.org
31.	Klubi Avokues për Personat me Aftësi të Kufizuara në Kosovë (KAPAK)	Prishtinë	kapak.ks@gmail.com
32.	Klubi për Politikë të Jashtme (KPJ)	Prishtinë	office@foreignpolicyclub.org
33.	Komunikimi Social (KOMS)	Pejë	komunikimi.social@gmail.com
34.	Kosova Democratic Institute (KDI)	Prishtinë	info@kdi-kosova.org
35.	Kosova Education Center (KEC)	Prishtinë	office@kec-ks.org
36.	Kosovo Foundation for Open Society (KFOS)	Prishtinë	info@kfos.org
37.	Kosovar Civil Society Foundation (KCSF)	Prishtinë	office@kcsfoundation.org
38.	Kristal	Mitrovicë	esatpeci@gmail.com
39.	Lëvizja FOL	Prishtinë	info@levizjafol.org
40.	Little People of Kosova	Mitrovicë	info@lpkosova.com hiljmnijeta@gmail.com

41.	Me dorë në zemër MDNZ	Mitrovicë	medorenezemer@yahoo.com
42.	Mundësia	Mitrovicë	mundesia_ngo@yahoo.com
43.	Mus-e Kosova	Prishtinë	mus-ekosova@hotmail.com
44.	Nisma e të Rinjëve për të Drejtat e Njeriut	Prishtinë	ksoffice@yih.org
45.	OJQ " Lets Shine Together"		elizza.h@hotmail.com
46.	OJQ "Durmish Asllano"	Prizren	nexhipmenekshe@gmail.com
47.	OJQ "FIERI"	Shtërpçë	garip_sahiti_12@hotmail.com
48.	OJQ "Integra"	Prishtinë	info@ngo-integra.org
49.	OJQ "KOHA"	Klinë	ojq.koha@gmail.com
50.	OJQ "Shtëpia e shokëve"	Mitrovicë	shtepiaeshokeve@hotmail.com
51.	OJQ "VENERA"	Pejë	ngo-venera@live.com
52.	OJQ VISTA	Prishtinë	vista_kos@yahoo.com
53.	Organizata Rinore "AKTI"	Fushë Kosovë	aktiora@hotmail.com
54.	Prehja	Skënderaj	qgprehja@hotmail.com
55.	Qendra Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarve të Torturës (QKRMT)	Prishtinë	info@krct.org
56.	Qendra Kosovare për Studime Gjinore (QKSGJ)	Prishtinë	qksgj_kgsc@yahoo.com info@kgscenter.net
57.	Qendra për demokratizim të shoqërisë civile Koralet	Mitrovicë	qdshc.mitrovica@gmail.com
58.	Qendra për Politika dhe Avokim (QPA)	Prishtinë	info@qpa-ks.org milaim.morina@hotmail.com
59.	Qendra për zhvillimin e Arteve- ARTPOLIS	Prishtinë	ojq.artpolis@gmail.com
60.	Qendra Rinore - Prizren	Prizren	prizrenyouthcenter@yahoo.com
61.	Qendra Rinore "At Lorenz Mazreku"	Pejë	atlorencmazreku@gmail.com
62.	Ridea	Prishtinë	ridea.institute@gmail.com
63.	RIINVEST INSTITUTE	Prishtinë	riinvest@riinvestinstitute.org
64.	Rromani Baxt	Prizren	kpacaku@yahoo.com
65.	Santa Marija	Mitrovicë	rblagica@yahoo.com
66.	Shoqata Afariste e Gruas SHE-ERA	Gjakovë	wsheera@gmail.com
67.	Shoqata e ekologëve "EKOSISTEMI"	Gjilan	e_sherifi@yahoo.com
68.	Shoqata e Gruas "Zana"	Klinë	info@ngo-zana.org
69.	Shoqata e juristëve "NORMA"	Prishtinë	info@norma-ks.org shoqatanorma@yahoo.com
70.	Shoqata e Paraplegjikëve dhe Paralizës së Fëmijëve të Kosovës - HANDIKOS	Prishtinë	handikos@handi-kos.org
71.	Shoqata e të verbërve e Republikës së Kosovës (SHVDP)	Prishtinë	shvpdk1@hotmail.com
72.	Shoqata Humanitare Bamirëse e Kosovës - Nëna Terezë	Prishtinë	ntereze@yahoo.com zefshala@hotmail.com
73.	Shoqata Kosovare për të Drejtat e Njeriut dhe Fëmijës (KAHCR)	Prishtinë	vsylhasi@kahcr-ks.org
74.	Shoqata për emancipimin e femrës "ALMA"	Pejë	shemsijeseferi2012@hotmail.com
75.	Shoqata për Mbrojtjen e Bjeshkëve të Nemuna "ARNIKA"	Pejë	arnika.ngo@gmail.com
76.	Shoqata për Teknologji të Informacionit dhe Telekomunikimit të Kosovës (STIKK)	Prishtinë	info@stikk-ks.org
77.	SOS Fshatërat e Fëmijëve	Prishtinë	info@sos-kosova.org
78.	Sport Sans Frontiere	Prishtinë	hom.kosovo@sportsansfrontieres.org
79.	Syri i Vizionit	Pejë	info@syriivizionit.org
80.	The American Chamber of Commerce in Kosovo (AmCham)	Prishtinë	info@amchamksv.org
81.	Udruženje Bošnjaka "OAZA"	Istog	ub_oaza@hotmail.com kemalkandic@hotmail.com
82.	UNI Group	Prishtinë	office@uni-group.org
83.	Youth Association for Human Rights (YAHR)	Lipjan	info.yahr@gmail.com
84.	Qendra Nacionale e Vëzhguesve të Kosovës (QNVK)	Mitrovicë	bujar_n@hotmail.com

85.	Network of Peace Movement (NOPM)	Kamenicë	ngo.nopm@gmail.com
86.	Qendra e Shoqërisë Civile Gjakovë (QSHC)	Gjakovë	ojqccs@gmail.com
87.	Caritas Kosova	Ferizaj	violeta.ferati@gmail.com
88.	Initiative for Kosova Community	Ferizaj	main@ngoikc.org
89.	European Centre for Minority Issues	Prishtinë	info@ecmikosovo.org
90.	National Analysis Centre for European Law	Prishtinë	sabiha.shala@gmail.com
91.	News Agency Kosova Live	Prishtinë	newsdesk@kosoalive.com
92.	Qendra për Hulumtim, Dokumentim dhe Publikim	Prishtinë	info@crdp-ks.org
93.	Svet Andjela	Mitrovicë	svetandjela@yahoo.com
94.	Gjeomjedisi	Mitrovicë	vehbigoxhuli@gmail.com
95.	Color ART	Mitrovicë	c-art2014@outlook.com
96.	Dobročinstvo, obrazovanje Nove Akcije DONA	Shtërpçë	nvo_dona@yahoo.com
97.	Fondacioni Together Kosova - FTK	Prishtinë	fondacioni.together@gmail.com
98.	Qendra për aftësimin e grave dhe fëmijëve për regjionin e Shalës	Mitrovicë	hamiti.hanife@hotmail.com
99.	Shoqata kosovare e psikologëve të rinj	Prishtinë	shoqataksepsiko@gmail.com
100.	Women for women international	Prishtinë	igashi@womenforwomen.org
101.	Mitrovica women association for human rights - MWAHR	Mitrovicë	mitrovica.wahr@gmail.com vetone_veliu@yahoo.com
102.	ANP Gjilan	Gjilan	nexhatismajli@yahoo.com
103.	Poslovno savetodavni centar Mitrovica Sever	Mitrovicë	pscms@ymail.com
104.	OJQ "Pasioni Rinor"	Vushtrri	pasionirinor@hotmail.com
105.	Klubi universitar i Debatit KUD	Prishtinë	udebateclub@yahoo.com osman.blaca@inpo-ks.org
106.	Developing Together	Prishtinë	info@developingtogether.org
107.	Omladinska Organizacija Kruševo	Dragash	nvokrusevo@yahoo.com
108.	Qendra për Arsim dhe Këshillim Profesional Gjon Nikollë Kazazi	Gjakovë	petrithasanaj@gmail.com
109.	Qendra për përkrahje dhe këshillim të femrës "Dora Dorës"	Prizren	info@doradores.org
110.	Centre for Political Courage - CPC	Prishtinë	info@cpc-ks.org
111.	IPKO Foundation	Prishtinë	info@ipkofoundation.org
112.	The Ideas Partnership	Prishtinë	theideaspartnership@gmail.com
113.	OJQ Konsumatori	Prishtinë	ok.kosova@gmail.com
114.	Civil Rights Program Kosovo - CRPK	Prishtinë	crp.pr@crpkosovo.org
115.	OJQ "LADY"	Prishtinë	ladyy_sani@hotmail.com
116.	Žensko Pravo	Mitrovicë	ruzicasimic@yahoo.com
117.	Rrjeti i Organizatave të Grave Rome, Ashkali dhe Egjiptase të Kosovës	Prishtinë	rrograek@gmail.com
118.	Kosova Population Foundation - KOPF	Prishtinë	rbatusha@kopfund.org
119.	OJQ Kelmendi	Zveçan	ojqkelmendi@gmail.com
120.	Kori i Femrave "Lira"	Prishtinë	ojqkorilira@hotmail.com
121.	Mitrovica Rock School	Mitrovicë	info@mitrovarockschool.org
122.	Këshilli i Prishtinës për Marrëdhënie me Jashtë - KPMJ	Prishtinë	info@prishtinacouncil.org
123.	Instituti per Kriminologji dhe Kriminalistikë	Prishtinë	iccj.rks@gmail.com
124.	OJQ Agro-Vet Development	Fushë Kosovë	info@agrovvet-ks.com
125.	Kosovo Education for Sustainable Development-KESD	Prishtinë	kosovo.esd@gmail.com
126.	Asociacioni i Ndërmarrësve të Rinjë të Kosovës	Prishtinë	info@smart-idea.eu
127.	Institute for Sustainability and Development of Youth - ISDY	Prishtinë	isdyp.rishtina@gmail.com isufhalimi@hotmail.com
128.	Qendra për Trajnime dhe Studime Gjinore	Prishtinë	qtsgj@yahoo.com arjetare@hotmail.com
129.	Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë	Prishtinë	info@qkss.org

130.	Initiative for Agricultural Development of Kosovo - IADK	Mitrovicë	zenel.bunjaku@iadc.org
131.	QKLKGJ "Jeta/Vita"	Prishtinë	jeta.vita@yahoo.com

